



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 27 shkurt 2023, me vota unanime nxjerr këtë:

MENDIM JURIDIK

PËR

SHPËRBLIMIN JUBILAR

(Lidhur me ligjin e aplikueshëm, marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar)

PJESA E PARË

Ligji i aplikueshëm:

- I. Për marrëdhëniet e punës që kanë lindur pas datës 15.12.2010, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr.90, datë 01.12.2010).

Marrëveshja/Kontratrat e aplikueshme:

- II. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur më datë 18.03.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca

Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), (në tekstin e më tejme: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës) aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015 – 31.12.2017.

- III. Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 11.04.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), (në tekstin e më tejme: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 11.04.2014) aplikohet në periudhën kohore nga data 01.01.2015 – 17.04.2017.
- IV. Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), (në tekstin e më tejme: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017) aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017 – 21.01.2021.
- V. Kontrata Kolektive Sektoriale e lidhur më datë 12.06.2021, dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës), (në tekstin e më tejme: Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2021) aplikohet në periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021.

PJESA E DYTË:

Kushtet për të fituar të drejtën shpërblimit jubilar:

- VI. I punësuar në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52, të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit.
- VII. Punëtorët që dalin në pension në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 11.04.2014, kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 36 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën III, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë të

punëdhënësi i fundit. Ndërsa për punëtorët që janë në marrëdhënie pune të cilët nuk kanë arritur moshën e pensionimit për shpërblimin jubilar aplikohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

- VIII. Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 35 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20, 30, dhe 40, vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën IV, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20, 30, dhe 40 vjet duhet të jetë te punëdhënësi i fundit.
- IX. Punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2021, kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20, dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik), dhe b) përvoja e punës për 10, 20, dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit.

Arsyetimi i Mendimit Juridik

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me çështjen e kërkesave për shpërblimin jubilar. Praktika jo unike e gjykatave të instancave më të ulëta kryesisht ka të bëjë me periudhën kohore që duhet të aplikohen marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.

Gjykata Supreme nga praktika e saj, por edhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e çështjes së shpërblimit jubilar, periudhën kohore që duhet të aplikohen marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar përmes një mendimi juridik.

Juridiksioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë mendim juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat. Me nenin 27 të këtij ligji, përcaktohet se seanca e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka të drejtë në nxjerrjen e qëndrimeve parimore, mendimeve juridike dhe udhëzuesve që promovojnë zbatimin unik të ligjeve, ndërsa nevoja e adresimit të kësaj çështjeje përmes mendimit juridik ka rrjedhë si propozim dhe konkludim i Degës Civile të Gjykatës Supreme, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të një numri të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore për çështjen e shpërblimit jubilar – gjegjësisht për periudhën kohore që duhet të aplikohen marrëveshja e përgjithshme

kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar, e po ashtu edhe nga kërkesat, pyetjet apo sugjerimet e gjykatave të rregullta apo gjyqtarëve.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nxjerrja e këtij mendimi juridik do t'i kontribuojë në radhë të parë unifikimit të praktikës gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarrjen gjyqësore për çështjen e shpërblimit jubilar, efikasitetit, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarrjes, efikasitetin dhe besueshmëri e publikut në gjykata.

Objekt i këtij mendimi juridik janë pothuajse të gjitha situatat e kërkesave, për periudhën kohore që duhet të aplikohen marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.

Arsyetimi i këtij mendimi juridik ndjek kronologjinë e çështjeve të trajtuara sipas ndarjes në pika.

Arsyetimi për pikën I (një) të mendimit juridik – Është standard i së drejtës civile që ligji material do të vlej në kohë të caktuar dhe territor të caktuar. Në këtë kontekst përcaktohet edhe zbatimi i dispozitave të Ligjit të Punës, duke marrë si bazë kohën e lindjes së marrëdhënieve juridike - civile.

Në praktikë është paraqitur si dilemë dhe në disa raste është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e ligjit i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies juridike – civile, nga lëmia e punës. Siç duket këto situata në disa raste kanë krijuar dilemën se cili ligj duhet të zbatohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjeve nga praktika e saj, por edhe sipas parimit për zbatimin e ligjit material përmes këtij mendimi juridik në pikën I, të këtij mendimi thekson se për të gjitha marrëdhëniet e punës që janë lindur pas datës 20.12.2012, për shpërblimin jubilar zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr.90, datë 01.12.2010). Nga kjo rrjedh se si ligj material do të zbatohet edhe sa i përket shpërblimit jubilar, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar, ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ka lindur marrëdhënia juridiko-civile.

Arsyetimi për pikën II (dy) të mendimit juridik - Sa i përket pikës II (dy) të këtij mendimi juridik, duke qenë se bëhet fjalë për zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, për periudhën kohore që duhet të aplikohet marrëveshja e përgjithshme kolektive, lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile të cilat kanë lindur nga data 01.01.2015, e tutje, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se kjo marrëveshje aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015 – 31.12.2017.

Arsyetimi për pikën II, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika II (dy) i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, parimisht e mbështet konceptin se edhe për kërkesat për shpërblim jubilar, zbatohen dispozitat e marrëveshjes e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është lindur marrëdhënia juridiko-civile, në qoftë se çështja kontestuese është gjykuar dhe vendosur nga ana e gjykatës deri sa ka qenë në fuqi ajo marrëveshje.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, dhe në disa raste janë zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, duke theksuar se e njëjta duhet të aplikohet nga data 01.01.2015 – 31.12.2018, me arsyetimin se nga kjo marrëveshje asnjëra palë nënshkruese nuk është tërhequr në afatin e paraparë prej tre muajve para skadimit, duku iu referuar nenit 81 paragrafi 1, me të cilin përcaktohet se: “Nga MPKK, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”. Në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “ Nëse nga MPKK, pasi që skadon afati i përcaktuar nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit ”.

Për Gjykatën Supreme të Kosovës, një përfundim i tillë është i gabuar, pasi Oda Ekonomike e Kosovës, si nënshkruese e kësaj marrëveshje, me njoftimin për tërheqje nga marrëveshja, i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës, më datë 09.11.2017, me nr. protokolli 01-499, i cili njoftim është publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës, më datë 13.11.2017, dhe nga kjo rezulton se tërheqja është bërë në afatin e paraparë me nenin 81 paragrafi 1 dhe 2, të marrëveshjes në fjalë dhe se e njëjta nuk ka vlefshmëri pas kalimit të afatit për të cilin është lidhur, pra pas datës 31.12.2017, për arsye se: fjalia e përdorur në nenin 81 paragrafi 1, ku përcaktohet se: “ Nga MPKK, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese ”, është fjali e dy kuptimshme, pasi nuk është e qartë nëse ka të bëjë me periudhën tre muaj para skadimit apo është fjala për tre muajt e fundit deri në skadimin e marrëveshjes, dhe nëse e marrim për bazë edhe formulimin “Nëse nga MPKK, pasi që skadon afati i përcaktuar...” në paragrafin 2, kjo dykuptimësi edhe më shumë shtohet dhe bëhet më e paqartë pasi nuk është e qartë se i referohet afatit të skadimit sipas paragrafit 1, të këtij neni, apo i referohet skadimit të afatit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, andaj në këtë rast bazuar në dispozitën e nenit 85, dhe 87, të Ligjit Nr. 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me të cilën përcaktohet se: “Dispozitat e paqarta në kontratën pa shpërblim duhet interpretuar në kuptimin që dispozita e rëndon më pak debitorin, ndërsa te kontrata me shpërblim në kuptimin me të cilin realizohet një marrëdhënie e drejtë e prestimeve reciproke”. Në këtë rast konkret Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, për nga natyra e saj në raport me punëdhënësit, është se krijon vetëm detyrime për të cilat nuk ka kundër shpërblim nga të punësuarit në raport me obligimet e krijuara nga kjo marrëveshje, andaj edhe duhet konsideruar se në rastin konkret me vetë faktin se Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje, me njoftim është tërhequr nga marrëveshja, nuk ka mundur të zbatohet neni 81 paragrafi 2, i kësaj marrëveshje.

Arsyetimi për pikën III (tre) të mendimit juridik – Sa i përket pikës III (tre) të këtij mendimi juridik, duke qenë se bëhet fjalë për zbatimin e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 11.04.2014, lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile të cilat kanë lindur nga data 01.01.2015,

Gjykata Supreme e Kosovës thekson se kjo marrëveshje aplikohet në periudhën kohore nga data 01.01.2015 – 17.04.2017.

Arsyetimi për pikën III, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika III (tre) i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 11.04.2014.

Arsyetimi për pikën IV (katër) të mendimit juridik – Sa i përket pikës IV (katër) të këtij mendimi juridik, duke qenë se bëhet fjalë për zbatimin e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë datës 18.04.2017, lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile të cilat kanë lindur nga data 18.04.2017, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se kjo marrëveshje aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017 – 21.01.2021.

Arsyetimi për pikën IV, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika IV (katër) i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017.

Arsyetimi për pikën V (pesë) të mendimit juridik – Sa i përket pikës V (pestë) të këtij mendimi juridik, duke qenë se bëhet fjalë për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018, lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile të cilat kanë lindur nga data 11.06.2018, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se kjo marrëveshje aplikohet në periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021.

Arsyetimi për pikën V, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika V, i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive Sektoriale, të datës 12.06.2018.

Arsyetimi për pikën VI (gjashtë) të mendimit juridik - Arsyetimi për pikën VI, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I dhe II, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika VI, i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se viti jubilar i punësimit për 10, 20, dhe 30 vjet, a duhet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20, dhe 30 vjet a duhet të jetë e pandërprerë të punëdhënësi i fundit. Në praktikën gjyqësore janë konstatuar interpretime, vlerësime dhe mënyra të ndryshme të vendosjes, lidhur me atë se cilat kushte duhet të plotësohen për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është se: i punësuarit në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20, dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20, dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i

fundit, për arsye se me nenin 52 paragrafi 1, të kësaj marrëveshje, përcaktohet se: “I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: a) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; b) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij dhe c) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij ”. Nga interpretimi i nenit 52 paragrafi 1 i kësaj marrëveshje, rezulton qartë se i punësuar për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar duhet ti plotësojë kushtet e theksuara si në pikën II, dhe VI, të këtij mendimi juridik.

Arsyetimi për pikën VII (shtatë) të mendimit juridik - Arsyetimi për pikën VIII, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I dhe III, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika VII, i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 11.04.2014.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se viti jubilar i punësimit për 10, 20, dhe 30 vjet a duhet të arrihet në kohën kur kjo kontratë aplikohet si në pikën III, të këtij mendimi juridik, dhe përvoja e punës për 10, 20, dhe 30 vjet, a duhet të jetë të punëdhënësi i fundit, si dhe e drejta për të kërkuar shpërblimin jubilar a iu takon vetëm punëtorëve që kanë arritur moshën e pensionimit, apo edhe atyre që janë akoma në marrëdhënie pune. Në praktikë gjyqësore janë konstatuar interpretime, vlerësime dhe mënyra të ndryshme të vendosjes, lidhur me atë se cilat kushte duhet të plotësohen për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është se: punëtorët që dalin në pension në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 11.04.2014, kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 36 paragrafi 9 të kësaj kontrate, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20, dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën III, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë të punëdhënësi i fundit. Ndërsa për punëtorët që janë në marrëdhënie pune të cilët nuk kanë arritur moshën e pensionimit për shpërblimin jubilar aplikohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, për arsye se me nenin 36 paragrafi 9, të kësaj kontrate, përcaktohet se: “Punëtorët që dalin në pension përfshinë pensionin jubilar në vlerë: a) për 10 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, b) për 20 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë, c) për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë, d) punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar dhe e) shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve ”. Nga interpretimi i nenit 36 paragrafi 9 i kësaj kontrate, rezulton qartë se punëtorët për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar duhet ti plotësojë kushte e theksuar si në pikën III, dhe VII, të këtij mendimi juridik.

Ndërsa për punëtorët që janë në marrëdhënie pune të cilët nuk kanë arritur moshën e pensionimit për shpërblimin jubilar aplikohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, për arsye se për punëtorët që nuk kanë arritur moshën pensionit sipas kontratës së theksuar me lartë nuk është përcaktuar e drejta në shpërblimin jubilar.

Arsyetimi për pikën VIII (tetë) të mendimit juridik - Arsyetimi për pikën VIII, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I dhe IV, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika VIII i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se viti jubilar i punësimit për 10, 20, 30 dhe 40 vjet a duhet të arrihet në kohën kur kjo kontratë aplikohet si në pikën IV, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20, 30 dhe 40 vjet a duhet të jetë te punëdhënësi i fundit, si dhe kjo kontratë a duhet të aplikohet nga data 18.04.2017 – 21.01.2021. Në praktikën gjyqësore janë konstatuar interpretime, vlerësime dhe mënyra të ndryshme të vendosjes, lidhur me atë se cilat kushte duhet të plotësohen për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar dhe për periudhën kohore që duhet të aplikohet.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është se: “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 35 paragrafi 8, të kësaj kontrate, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20, 30 dhe 40 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën IV, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20, 30 dhe 40 vjet duhet të jetë te punëdhënësi i fundit, për arsye se me nenin 35 paragrafi 8, të kësaj kontrate, përcaktohet se: “Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti”. Nga interpretimi i nenit 35 paragrafi 8 i kësaj kontrate, rezulton qartë se punëtorët për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar duhet ti plotësojë kushtet e theksuara si në pikën IV, dhe VIII, të këtij mendimi juridik.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, kjo kontratë duhet të aplikohet nga data 18.04.2017 – 21.01.2021, për arsye se me nenin 45 të kësaj kontrate, përcaktohet se: “Nga KK, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon se zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga KK, pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit. Pas skadimit të afatit të KK-së, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmujorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër”, ndërsa me nenin 47 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, përcaktohet se: “Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate shfuqizohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë në mes të MASH dhe SBASHK Nr. 01B/2056, datë 18.04.2017.” Nga interpretimi i dispozitave të cituara të këtyre kontratave, rezulton qartë se kjo kontratë aplikohet për periudhën kohore nga data 18.04.2017 – 21.01.2021, për arsye se asnjëra palë nënshkruese nuk është tërhequr në afatin e paraparë prej tre muajve para skadimit siç përcaktohet me nenin 45 të KK-së, së datës 18.04.2017, dhe për faktin se me KK, të datës

21.01.2021, me nenin 47 është shfuqizuar kontrata e mëparshme, çka nënkupton se palët me vullnetin e tyre kanë pranuar vazhdimin e saj, dhe e njëjta është e aplikueshme për periudhën kohore si në pikën IV, të këtij mendimi juridik.

Arsyetimi për pikën IX (nëntë) të mendimit juridik - Arsyetimi për pikën IX, të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I dhe V, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika IX, i referohet marrëdhënieve juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është se: Punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018, kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 paragrafi 3 dhe 4 të kësaj kontrate, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20, dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20, dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit, për arsye se me nenin 17 paragrafi 3, dhe 4, të kësaj kontrate, përcaktohet se: “Punëtorët shëndetësorë, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij, për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij, për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni, përcaktohet se: “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Nga interpretimi i nenit 17 paragrafi 3 dhe 4 i kësaj kontrate, rezulton qartë se punëtorët për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar duhet ti plotësojë kushtet e theksuara si në pikën V, dhe IX, të këtij mendimi juridik.

(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur me datë 27 shkurt 2023)